



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:266671

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05637075

KPPP.nr.2065/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “LEAF MANAGMENT” Sh.P.K., me seli në Rr. Magjistranja Ferizaj-Shkup pn, me NUI: 810007030, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Labinota Qosa-Ilazi dhe Burhan Qosa avokatë me seli të zyrës në Ferizaj, kundër debitorit “Hangover Club” Sh.P.K., me seli në Gjakovë Rr. “Gasper Karaqi”, me NRB: 811586075, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.692/23 të datës 08.11.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli me seli të zyrës në Ferizaj, jashtë seancës me datë 25.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Hangover Club” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.692/23 të datës 08.11.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli, dhe i njejtë Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimi të debitorit në shumë të përgjithshme prej 78 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.692/23 të datës 08.11.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës Nr.#8A të datës 05.08.2023, me të cilin e ka obliguar që t’ia paguajë borxhn kreditorit në shumë prej 3,000.00 Euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, dhe atë duke filluar nga dita e arritjes për pagesë të faturës e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim në të cilin ka theksuar se nuk e konteston faturën me nr.#8A të datës 05.08.2023 të datës 05.08.2023, duke shtuar se debitori ka kërkuar nga kreditori që t’i japë një afat kohor për pagimin për shkak të problemeve financiare, për çka për një afat sa më të shkurtër do t’ia shlyejnë këtë borxh kreditorit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet ndërsa urdhri mbi lejimin e përmbarimit të shtyhet dhe të pezullohen të gjitha veprimet përmbarimore.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se debitori me prapësimin e tij nuk e ka kontestuar faturën nr.#8A të datës 05.08.2023 të datës 05.08.2023, dhe se kreditori i ka dhënë afatin shtesë të kërkuar, dhe diku pas 9 apo 10 dite nga data e kontaktit me debitorin, çështjen e ka dërguar në përmbarim. Ka shtuar se debitori ka tejkalluar çdo parim të ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë në marrëdhënien e tyre që kishin, pasi që kreditori edhe para gjykatës me prova të pakontestueshme e dëshmon se debitorit disa herë i ka dhënë afat shtesë për përmbushjen e detyrimit që ai e kishte ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar ndërsa të lihet në fuqi urdhri mbi caktimin e përmbarimit, si dhe të obligohet debitori që kreditorit t’ia paguajë përveç shpenzimeve procedurale, edhe shumën prej 156.00 Euro në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes*

së detyrimit monetar”. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, ka evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbardim dokumentin e besueshëm/faturën Nr.#8A të datës 05.08.2023, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur përmban të gjitha elementet të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37 për zbatimin e përmbardimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, e njejta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet me vulën e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbardimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbardimit, numri i palëve të përfaqësuar, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.2065/23, me datë 25.04.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njejtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.